

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1.1 të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), si dhe nenet 56 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më datën 09 nëntor miratoi si vijon:

## **RREGULLORE PËR PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT NGA BANKAT**

### **Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë informacionin që bankat duhet të publikojnë, si dhe mënyrën, formën dhe afatet kohore për publikimin e tij në funksion të rritjes së transparencës dhe disiplinës në sektorin bankar, si dhe për të siguruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e sektorit bankar.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2 Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore janë përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (këtu e tutje: *Ligji për bankat*) dhe / ose siç përcaktohet më tutje për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - a. *Viti financiar* - nënkupton periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të atij viti.

### **Neni 3 Kërkesat për procedurat e publikimit dhe karakteristikat e informacionit**

1. Bankat duhet të hartojnë dhe të aprovojnë akte të brendshme për procedurat e përgatitjes dhe publikimit të informacionit, të cilat duhet të përmbajnë llojin e informacionit për publikim, shpeshhtësinë e publikimit dhe sistemet e kontrollit në procesin e publikimit.
2. Bankat duhet të publikojnë informacion mbi rreziqet ndaj të cilave ekspozohen në veprimtarinë e tyre, duke dhënë një pamje të përgjithshme të profilit të rrezikut.
3. Informacioni i publikuar nga bankat duhet të jetë i një natyre materiale, që t'i përshtatet dhe shërbejë kërkesave vendimmarrëse të përdoruesve të tij dhe t'i ndihmojë ata në vlerësimin e rreziqeve dhe fitimeve të pritshme të investimeve të tyre, të ekspozimeve të tjera të mundshme ose të performancës dhe të gjendjes financiare të ardhshme të veprimtarisë së tyre.
4. Sipas kësaj Rregulloreje, informacioni do të konsiderohet i natyrës materiale në rastet kur përjashtimi ose deklarimi i tij i gabuar, mund të ndikojë ose të ndryshojë vendimin ekonomik të përdoruesit të këtij informacioni.

5. Bankat duhet të publikojnë informacion të besueshëm që reflekton gjendjen ekonomike të tyre. Ky informacion duhet të jetë i verifikueshëm në çdo kohë, i plotë në të gjitha aspektet që paraqesin rëndësi për përdoruesin.
6. Bankat duhet të paraqesin datën e publikimit të informacionit. Në raste të korrigjimit të informacionit të publikuar nga bankat ato duhet të publikojnë edhe datën e korrigjimeve të bëra.
7. Bankat duhet të përdorin si shenjë dalluese në publikimet e tyre stemën e bankës së tyre.
8. Bankat nuk duhet të publikojnë informacione të cilat konsiderohen konfidenciale ose sekrete për klientët e tyre në bazë të ligjeve apo akteve nënligjore të aplikueshme ose informacione të tjera të cilat mund të kenë ndikim në pozitën konkurruese të tyre në treg.
9. Bankat duhet të publikojnë informacion rreth veprimtarive për të cilat janë licencuar, informacion të përgjithshëm për bankën, informacion mbi strukturën e aksionarëve, strukturën e organeve drejtuese dhe strukturën organizative të tyre.
10. Informacioni i kërkuar në paragrafin 9 të këtij neni duhet të jetë i publikuar në çdo kohë në faqen e internetit të bankës dhe duhet të rifreskohet sa herë që ka ndryshime.
11. Bankat duhet të publikojnë informacionin në njërën nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe mbi baza vullnetare edhe në gjuhë të tjera.

#### **Neni 4** **Publikimi i raporteve vjetore**

1. Paragrafi 2 i nenit 56 të Ligjit për bankat kërkon, që bankat brenda 4 muajve nga mbyllja e vitit të tyre financiar të publikojnë raportet e tyre vjetore, të cilat përmbajnë pasqyrat e audituara financiare. Neni 53 i Ligjit për bankat mbi llogaritë dhe pasqyrat financiare specifikon që raportet duhet të përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), duke pasqyruar rregullat dhe standardet shtesë të përcaktuara nga BQK-ja.
2. Përveç informacionit të kërkuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, në raportet e tyre vjetore bankat duhet të shpalosin si në vijim:
  - a. Veprimtarinë kryesore të bankës, organizimin dhe drejtimin e përgjithshëm;
  - b. Performancën financiare;
  - c. Gjendjen financiare, përfshirë të dhënat mbi shumën e fondeve vetanake dhe atyre mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, aftësinë paguese (solventitetin) dhe likuiditetin;
  - d. Praktikën dhe strategjitë e menaxhimit të rrezikut;
  - e. Ekspozimet ndaj rreziqeve (përfshirë rrezikun kreditor, rrezikun e tregut, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional dhe rreziqet e tjera të mundshme); dhe
  - f. Politikën e kontabilitetit.
3. Informacioni që përfshihet në paragrafin 2 të këtij neni duhet të paraqitet qartë dhe në mënyrë të përshtatshme me qëllim, që të arrihet një nivel i mjaftueshëm i transparencës bankare.
4. Bankat duhet të dorëzojnë një kopje të raportit të tyre vjetor në BQK dhe të publikojnë atë në faqen e tyre të internetit.

5. Ky nen aplikohet për degët e bankave të huaja në rastet kur BQK-ja, kërkon auditim të veçantë për pasqyrat financiare të veprimtarisë së tyre në Kosovë. Në të kundërt, degët e bankave të huaja duhet të publikojnë raportin vjetor të konsoliduar të bankës amë.

## **Neni 5 Publikimet tremujore**

1. Bankat duhet të publikojnë bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave së paku në një gazetë ditore me mbulueshmëri në nivel të vendit dhe në faqen e tyre të internetit brenda 30 ditëve nga përfundimi i secilit tremujor sipas formularëve të paraqitur në këtë nen.

2. Përmbledhja e publikuar tremujore e bilancit të gjendjes dhe pasqyrës së të ardhurave duhet të jetë e saktë dhe e vërtetë dhe të jetë në përputhje me përmbledhjen e periudhës së mëparshme, e cila duhet të përfshihet si referencë. Në rast të ndryshimit të metodave të aplikuara të kontabilitetit, projeksionet e periudhës së mëparshme duhet të përcaktohen dhe publikohen në pajtim me metodat e reja.

3. Përmbledhja preliminare e bilancit të gjendjes dhe pasqyrës së të ardhurave për tremujorin e katërt, që përfundon më 31 dhjetor, duhet të publikohet brenda 30 ditëve pa pritur opinionin e auditorëve të jashtëm, pa cenuar obligimin për të publikuar bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave përfundimtare të audituara brenda katër muajve pas përfundimit të vitit financiar së bashku me opinionin e auditorit të jashtëm.

4. Bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave duhet të përpilohet sipas SNRF-së duke pasqyruar rregullat dhe standardet shtesë të përcaktuara nga BQK-ja dhe të publikohet në pajtim me formularët në vijim:

**Bilanci i gjendjes me: (datë)**

**Euro ‘000**

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
<b>Pasuritë</b>		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në		
Kërkesat ndaj bankave		
Bonot e thesarit		
Investimet në letra me vlerë		
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve		
Patundshmëritë dhe pajisjet		
Pasuritë e paprekshme		
Pasuritë tatimore të shtyra		
Pasuritë tjera		
<b>Gjithsej pasuritë</b>		
<b>Detyrimet</b>		
Depozitat e klientëve		
Detyrimet ndaj bankave		
Fondet tjera të huazuara		

Detyrimet tatimore të shtyra		
Detyrimet tjera		
<b>Gjithsej detyrimet</b>		
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>		
Kapitali aksionar		
Rezervat e kapitalit		
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake		
Fitimi/(humbja) e vitit aktual		
Përbërësit tjerë të ekuitetit		
<b>Gjithsej ekuiteti i aksionarëve</b>		
<b>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve</b>		

Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: datë

Euro '000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi		
Shpenzimet e interesit		
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>		
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet		
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve		
<b>Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet</b>		
Neto të hyrat nga tregtimi		
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare		
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative		
<b>Gjithsej të hyrat</b>		
Provizionet për humbjet nga kreditë		
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>		
Shpenzimet e tatimit në fitim		
<b>Fitimi/(humbja) neto</b>		
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>		

6. Bankat duhet të dërgojnë në Departamentin e Mbikëqyrjes Bankare në BQK një kopje të gazetës në të cilën kanë publikuar përmbledhjen tremujore të bilancit të gjendjes dhe pasqyrës së të ardhurave.

7. Bankat, gjithashtu duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit treguesit e mëposhtëm financiar në baza tremujore:

- a. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali ndaj mjeteve të peshuara me rrezik);
- b. Treguesi i kthimit në mjetet mesatare (KMM) (të hyrat neto ndaj mjeteve mesatare);
- c. Treguesi i kthimit në ekuitetin mesatar (KEM) (të hyrat neto ndaj ekuitetit mesatar);
- d. Margjina neto e interesit (të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare fitimprurëse);
- e. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë ndaj të hyrave bruto të veprimtarisë;
- f. Të hyrat neto nga interesi ndaj shpenzimeve të përgjithshme të veprimtarisë;
- g. Gjithsej mjetet ndaj numrit të punëtorëve të regjistruar;
- h. Të hyrat neto nga interesi ndaj mjeteve mesatare;
- i. Të hyrat nga interesi ndaj mjeteve mesatare;
- j. Shpenzimet për interesa ndaj mjeteve mesatare;
- k. Të hyrat neto nga interesi ndaj të hyrave bruto të veprimtarisë;
- l. Shpenzimet e personelit ndaj të hyrave bruto të veprimtarisë;
- m. Shpenzimet e provizioneve ndaj mjeteve mesatare.

## **Neni 6**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkeljet e kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve të parashikuara në nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për bankat.

## **Neni 7**

### **Shfuqizim**

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregulla XXIV e BQK-së për publikimin e përmbledhjes së gjendjes së bilancit tremujor e aprovuar më 19 shtator, 2003 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë rregullore.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi me datën 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Gazmend Luboteni